



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 26/09/2023
Nr. 5/3296

Komisioni për licencimin e BPrAL / kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesën nr. 5 me nr. protokolli 3296 të datës 13.09.2023 të parashtruar nga BPrAL - kolegji "UBT" për licencim / rilicencim dhe mori këtë :

V E N D I M

1. Licencohet në nivel institucional Bartësi Privat i Arsimit të Lartë - kolegji "UBT" për degët Prizren dhe Ferizaj për periudhën trevjeçare 1 tetor 2023 deri me 30 shtator 2026 sipas vendimeve ref.444/23 datë 06.04.2023 si dhe vendimit ref. 443/ 23 datë 06.04.2023.
2. Në kampusin kryesor – Prishtinë, sipas vendimit ref. 1017/23 datë 26.07.2023, licencohen programet:
 - 2.1). Menaxhim Biznesi dhe Ekonomi BSc 180 ECTS(1 tetor 2023 – 30 shtator 2028)
 - 2.2). Menaxhim Biznesi dhe Ekonomi MSc 120 ECTS (1 tetor 2023 – 30 shtator 2028)
 - 2.3). Juridik LLB 240ECTS ; (1 tetor 2023 – 30 shtator 2026)
 - 2.4). Biokimi MSc 120 ECTS;(1 tetor 2023 – 30 shator 2026)
 - 2.5). Psikologji BSc 180 ECTS;(1 tetor 2023 – 30 shator 2026).
3. Në kampusin kryesor – Prishtinë, licencohet për periudhën kohore 1 tetor 2023 deri me 30 shtator 2024, sipas vendimit ref. 1203/23 datë 15.09.2023 programi i studimit : Infermieri BSc 180 ECTS.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, Komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas

shqyrtimit të kërkesës nr.5, me nr. protokoli 3296 të datës 13.09.2023, të parashtruar nga kolegji “UBT”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim dhe rilicencim.

Kohëzgjatja e zhvillimit të veprimtarisë së programeve të akredituara është specifikuar në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi, ndërkaq pika 1 e vendimit specifikon licencimin institucional në degët – Prizren dhe Ferizaj.

Komisioni për licencim i MASHTI, duke marrë parasysh faktet e këtij institucioni të paraqitura në dokumentacionin e kompletuar ligjërisht për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtrojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi te Sekretari i përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. Arkivit.

Kryetar i Komisionit


Burim Gashi